

BIBLIOTEKA

E

8JH-1

K 78

SHTETI



Klara Kodra

**BISEDË
ME
VËLLEZËRIT**
poezi

85H-1.

K78

Klara Kodra

Bisedë
me
vëllezërit
poezi

48020

SHËNËTË BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

TOK ME FSHATARËT

Jemi mbledhur tok me fshatarët,
marrim në dorë bukën
si plisat në arë,
dhe fjalët rrjedhin
si rrëketë në lumë.
Atdheu s'është vetëm në vijat e hartave,
po dhe në vijat e këtyre fytyrave,
që të malluara na shohin
si prindi bijtë.

PARTISË

Drejt teje
krahët i kam shtrirë.
Vargjet e mia mbushen me ty
si syri me hapësirën.

LETËR. NGA METALURGJIKU

E dashur mësuese,
s'e fsheh, herë-herë
unë fëmija e panënë,
kam rënë në mendime
dhe me krahët e ëndrrave
kam kërkuar nënën time
me fytyrë të pakapshme
(dhe nëna për fëmijën është
e gjerë sa një botë),
po tani ajo fytyrë
më ngjan si fytyra jote
dhe desha që të puth
prej së largu ato duar
që bënë që fëminija ime
të mos jetë kurrë e trishtuar.
E dashur mësuese,
çdo njeri ka një rrugë,
e unë tani jam metalurge.

Do të doja të shihje
që i kam duart e forta
dhe shpirtin më të fortë,
ashtu si më gatoi
fjala dhe dora jote.
E dashur mësuese,
do doja që këto radhë
t'ishin krahë që të të rrokja
në këtë ditë të bardhë.

BALADË IRLANDEZE

Harold Uillsoni shkel në tokën e Irlandës
dhe sjell me vete
fjalë,
fjalë,
fjalë
me të cilat do t'ua ngrohë zemrat ushtarëve...

Por ato fjalë
janë të zbeta,
si para agimit
drita e një llampe.
Nëpër uniforma ushtarët anglezë kanë ngrirë
dhe vjen Harold Uillsoni
dhe u sjell një xixëllim fjalësh.
Ata vazhdojnë të ngrijnë,
sepse bijtë e Irlandës
nuk e quajnë aspak Anglinë

nënë e tyre të mirë,
sepse bijtë e Irlandës
tani kanë sy,
sepse bijtë e Irlandës kanë duar që shtrëngojnë
pushkën
dhe bijtë e Irlandës po ngrohen në zjarr të luftës
kurse anglezët në uniformat e ndritura kanë ngrirë.

THJESHTËSI

Ti je e dashur, e qetë, e thjeshtë
dhe veç unë ta di thellësinë;
qeshin ëmbël sytë bojë lëndine,
derdhen lirshëm flokët ngjyrë vjeshte.

E di, flokët s'i ke si floriri,
sytë si nata a zënë si violinë,
e thjeshtë, kokulur, si kalliri,
u buzëqesh ditëve që vijnë.

Duart e tua dinë të ndezin penën,
dinë fëmijët t'i ledhatojnë,
kapin kazmën a shtizat, të lehta,
veç një gjë s'dinë ato: të pushojnë.

Sytë, si deti që thith pareshtur
valë lumenjsh, thithin pa pushim
dashuri nga zemra e njerëzve
dhe e derdhin prapë si burim.

Ti je e dashur, e qetë, e thjeshtë
dhe s'kupton si mes vargjesh u gjende.
Ndërsa shkruaj këto rreshta në heshtje
thith si ajrin dashurinë tënde...

Z È R I Y T

Zëri yt i largët, i largët,
prapë më vjen me flladin e verës.
Buzëqeshja jote tërë flakë
më rindizet në rrezet e pranverës.

«Gjyshja, — thoshe, — është dy herë nënë»,
eja, shih se si bredh në çdo kënd
ajo çupëz e bukur çapkëne
që sërish e ringjalli emrin tënd.

Ti tani do të ishe shtatëdhjetë,
po të ishe... akoma ndër ne,
po ti mbete përjetë, përjetë,
nënë e shtrenjtë, e re, e re...

PËRSHËNDETJE

Nga dritaret e maternitetit
klithma të mprehta
që përshëndesin jetën
dhe ngazëlajnë nënat...
edhe në kthetrat e dhimbjeve të lindjes
Gëzimi që zbulon jetën
është një mijë herë më i fortë se dhimbja.

ZEMRA BËHET SHQIPE

Marigo Pozios

Zemra thellë hyn në gjilpërë,
bëhet shqipe krahëshkruar,
derdhet gjaku e zjarri i tërë
në flamurin e bekuar.
S'është zog që fluturon,
është dorë e Marigosë,
dhe ja, flamuri valon,
i derdh rrezet përmbi Vlorë...

KËNGA E TIPOGRAFËVE

Shkrimtari brodhi kaq shtigje e kaq udhë,
pastaj ra në mendime te tryeza
dhe pena fluturoi. Ne tani në tri turne
radhisim gërmat e zeza.

Dhe duart tona marrin ngjyrën e këtyre gërmave
dhe ne lëmë mbi to pagjumësinë tonë,
pastaj ato gjithkund do rendin me shpejtësinë
e zemrave
dhe kudo do lënë jehonë.

ZËRI I FUSHËS

Në çdo kalli gruri
është pika e djersës
dhe rrezja e diellit.
Toka ngjan si pa caqe
si kaltërsia lart mbi ne.
Fusha thith djersën e buzëqeshjet tona
dhe bëhet për ditë
më e re.

POEZISË

E bukura ime, ka që të krahasojnë me vel e me
mjegull,
që duart shtrijnë etshëm t'i kapin e nga duart
u ikin gjithnjë.
Po unë e di që ti ngjan me një të gjelbëruar
pjergull
me vile të mëdha të praruara, ku rreze vetë
dielli lë.
Nga kokrrat e tua të arta pikon lëngu i
jetës,
që ne kemi thithur me vrull si fëmijë të
uritur
dhe zemrën e mbushëm përplot dhe pastaj
si bletët
sërish krijuam me durim prej tij një
lëng të ndritur.

Ky lëng i ndritur merr nga gjaku ynë,
ky lëng merr nga djersa e nga buzëqeshjet
dhe ne ua shtrojmë njerëzve të pinë:
«Vëllezër! Shuajeni etjen!»



KËNGË PARTIZANE

Plaga pikoi gjak
dhe bredhi rrëshirë.
Ai hapi sytë.
Qielli ishte i dliurë.

Donte që të fliste,
po nuk fliste dot.
Bebëzat e kthjellta
s'kishin asnjë lot.

Kishte ikur nata,
vinte tjetër ditë;
plaga rridhte gjak,
qielli rridhte dritë.

ARDHJA E PRANVERËS

Lulet e bajameve
të bardha e të trëndafilta
ngrenë kryet
pa u trembur
nga thëllimi.
Ndër rrugët,
në trotuare,
në lulishte
derdhet dielli
si një ujvarë e artë
gëzimi.

ÇAST NË KUFI

Dëbora zbardh
në vend të dritës së hënës.
Mbështetem te toka e te pushka
si biri te dora e nënës.

PËR ATA QË NUK VDESIN

Ashtu si nëna ia rregullon jastëkun
djalit,
që gjumi i tij të rrjedhë më
i qetë,
te kryet tuaj fëmijët pastronin
barin.

Dhe poshtë qyteti ziente
tërë jetë,
Një tufë trëndafilash
u këputën
nga gjiri i atdheut e aty u kthyen
sërish;
te kryet tuaj, roje që nuk tundet,
ylli i kuq për fitore prapë të grish.

MENDIMET E NJË MËSUESEJE TË RE
NJË DITË PRANVERE

Vjollcat hapin sytë kureshtare në
livadhe
dhe përziejnë cicërimet fëmijët dhe
dallëndyshet.

Mbi bluzën time ka rënë shkumësi
si borë e bardhë...

Dhe ajri, dielli sepse duken ndryshe.
E di, më duhet që të mbaj qetësinë,
po e shqetësuar është natyra vetë.
A i ndalon dot zogjtë të cicërijnë?
A i ndalon dot pemët që të çelin
fletë?

E di, më duhet që të them shumë gjëra.
Po flladi pranveror më shumë
flet...

Dhe a është e mundur që t'i
thuash të tëra,

a është e mundur t'i zbërthesh
tërë psetë?
Tani kërcejtë janë mbushur plot
me fletë
dhe mendjet janë mbushur plot
me pyetje.
A bëhem dot burimi tërë jetë
që t'ua shuaj atyre të pafundmen etje?

SHOQES SË KURSIT

Atë vështrim të qartë
m'hedhin sytë si bajame.
Me gishtërinjtë e artë
dielli troket në xhame.

Provimi i fundit pret.
Pastaj provimi i jetës.
Buzët e tua të çelura
si lule që hapin fletët.

Na ndajnë pak hapa,
më vonë kilometrat.
Me gishtërinjtë e artë
në xhame troket dielli.

Do na ndajnë kilometrat,
do na lidhin mendimet
si na lidhën kaq vjet
gazet dhe shqetësimet.

1965

MË DUKET...

Çdo mëngjes si një rrymë gëzimi
më përshkon trupin dhe më ngroh.
A mos vallë kjo vjen nga mendimi
se sërishmi unë ty do të t'shoh?

Çastet pranë teje i mbledh si perla
të çmueshme
që thellë thellë në fund të detit janë strukur
Eja. Të pres me mall. Jeta është e bukur,
kur jam me ty veç është e mrekullueshme...

BREDHI I VITIT TË RI

nipërve të mi

Larg është bora,
larg është pylli,
po ja për ju
në dhomë ai ka hyrë
dhe ju vështroni;
ja degët që janë fryrë
nga flokët e borës
dhe lart i ndritshëm ylli.
Dhe rreth e rrotull
arinjtë, lepujt,
qentë, dhelprat
edhe ketrat.
Ata vështrojnë
dhe po ju flasin,
ashtu siç ngjet
nëpër pralla të vjetra.
Viti i Ri me të vjetrin
se ç'po flet.

Njëri i thinjur si bora,
tjefri i gjelbërt si pylli.
Bota e madhe
me gjithë zë
ju thërret.
Ju shtrini duart
për të kapur yllin.

ÇELIKU LIND PËRMES ZJARRIT

*Punonjësve grevistë anglezë të
industrialisë së çelikut.*

Nën duart tuaja, vëllezër,
nga zjarri lind çeliku
dhe ata duan t'ju flakin tutje
si flak gjethet shtrëngata.
Vëllezër, çelik jeni vetë
dhe zjarri i shpirtit tuaj
çelikon mund të tretë.
Prandaj zëri juaj padronëve
do t'u përgjigjet gjithnjë:

«Jo!»

Çeliku, vëllezër,
lind nëpërmjet zjarrit
dhe forca juaj
lind nëpërmjet zjarrit.
Në qoftë se thoni sot «Jo!»
nesër, vëllezër,
së ardhmes do t'i thoni «Po!»

Ata duan t'ju flakin në rrugë,
si flak era gjethet e thata,
po kanë harruar
se jeni ju shtrëngata.

1976

NE, VULLNETARËT

Ecim në radhë,
sytë janë mbushur me livadhet.
Në veshë na ushton komanda.
Pastaj biem barkas, qëndrojmë shtrirë;
përqafojmë armët dhe tokën erëmirë.
S'ka gjë që gishtërinjtë na
kanë ngrirë.

Dhe sërish në radhë.
Kur ecim ne ngjan se ecin
vetë livadhet.
Në gjelbërimin e tokës sonë jemi
shkrirë.

VARGJE NË KRUIJË

Çeli zemra e shkëmbit
dhe lindi qyteti.

Çeli zemra e popullit
dhe lindi Gjergji.

Mbeti qyteti
në lartësi.

Dhe emri i heroit
në lavdi.

DHURATË MBESËS PËR 1 MAJIN

Sytë e tu janë ende si pasqyrë
që vetëm merr nga bota jashtë dritë.
Ti nuk e di ç'është kjo e kuqe ngjyrë.
Ti nuk e di pse e festojmë këtë ditë.
Ti ende s'di të rendësh e gëzuar,
ç'them të rendësh, ti s'di ende të ecësh.
Po të ngre lart mami yt në duar,
po të ngre lart unë në krahët e

këngës.

Doçkat e tua, që mezi kapin lodrat,
hapin gishtërinjtë që të kapin

retë.

Po, kape qiellin, është për ty e
për motrat,
thithe të bukurën gjithkund porsi bletë.
Ti nuk e di ç'është kjo e kuqe ngjyrë,
ti nuk e di pse e festojmë këtë
ditë.

Po trëndafilat i ke në fytyrë.
Në sy e në buzë ke të diellit
dritën.

Po të ngre lart mami yt në duar,
po të ngre lart unë në krahët e këngës,
që nesër botën ta mbash ti në duar,
që tok me vëllezërit t'mbjellësh
farën e jetës.

SHOQES SË DIKURSHME TË AKSIONIT

S'e di, e mban mend kur nga mbrëmja e vallzimit
shkonim në turnin e tretë?
Ti tani mbledh në klasë fëmijët e ndofta je nënë
vetë.
Mban mend kur në mes radhëve tona erdhe me
dorë të lidhur?
E hidhur dhimbje, po prej shoqesh të ndahesh më
e hidhur.
Ura na thithte gjumin, po dhe na jepte aq shumë
gëzim.
Tani mbi të treni rend e rend me nxitim.
Atëherë shqetësoheshim për flamurin e garës dhe
e kishim në mendje përherë.
Tani shqetësimet tona janë të shumta si kokrriza
rëre.
Po e bukur jeta tani, se çdo ditë na zbulon
diçka të re
Mbi shina kujtimi rend treni i mendimit e përsëri
na lidh ne.

*
* * *

Kur t'i harroj lulet,
tejdukshmërinë e kaltër të qiellit,
kur të harroj frymëmarrjen e tokës,
ngrohtësinë e rrezeve,
kur të harroj gazin,
kur të harroj dhimbjen,
atëherë do të të harroj ty.
Ne po ndahemi
ashtu si ndahet dielli nga toka
për një takim
të qeshur
e të ri.

FJALËT E PARA

Mari Kyrisë

... Dhe fjalët thyen akullin e brishtë
të heshtjes.¹⁾
Dhe fjalët ngritën një urë midis njerëzish.
Ti, e para grua po flisje në atë katedër
dhe ishe aq krenare dhe e thjeshtë.

Mbi zemër të rëndonte dheu i lagësht
që shtypte shokun e bashkëluftëtarin.
Në bebëza të valëzonte një kohë e afërt.
Radiumi po lëshonte dritë të kaltër.

1) Pas vdekjes së të shoqit, Pier Kyrisë, shkencëtarja e shquar zëvendësoi atë në katedër.

Në zërin tënd luftonin e re dhe e vjetër,
flisnin tërë gratë që u shuan në heshtje,
s'ishe veç ti, Mari, në atë katedër...

KTHIMI

*Dëshmorëve të rënë në Jugosllavi
që u kthyen në atdhe*

Ata u kthyen te e shtrenjta tokë nënë,
që s'e panë më kurrë për së gjalli
e që në tym e flakë e patën lënë.
U kthyen. Dhe nën dhe i dogji malli.

U kthyen. Qielli është si pasqyrë
dhe turma derdhet si valë e furishme.
Toka jonë priste qëkur eshtrat e tyre
për t'u bërë akoma më e fuqishme.

1975

ÇAST AKSIONI

Këtu ne jemi që të gjitha vajza,
po këtë natë na duket se jemi bërë nëna,
i këndojmë ninullë një foshnje vigane,
qumështin e dritës valë-valë derdh nëna.

Duart i lëvizim të shpejta si flutura
për të ngritur në këmbë urën tonë të dashur,
i këndojmë ninullë me këngë të bukura,
pa çka se këmba na shket te toka e lagësht.

I këndojmë ninullë jo ta vëmë në gjumë
këtë foshnjë vigane prej hekuri e betoni,
i këndojmë ninullë që të rritet më shumë
dhe mbi të të ecë pa u ndalë revolucioni.

Këtu ne jemi që të gjitha vajza,
po këtë natë na duket se jemi bërë nëna,
i këndojmë ninullë një foshnje vigane,
qumështin e dritës valë-valë derdh nëna.

BUZË LIQENIT TË POGRADECIT

Dhe uji ngjante si kristal i kthjellët.
Dhe u shkrinë vala, mali edhe qielli.

ANXHELIKA MAJER

*Pranë qytetit Ofenbah të Gjermanisë
Perëndimore një vajzë e vogël me
emrin Anxhelika Majer ngriu nga të
ftohtit në një barakë derrash, ku
banonte bashkë me t'ëmën e të vë-
llezërit. Vdekjen e saj gazetat bor-
gjeze ia atribuan pakujdesisë së në-
nës.*

Nga shtypi

Anxhelika Majer kishte dy sy të mëdhenj, të
mëdhenj.

Sytë e saj tërë dritë ishin si liqene,
si liqene plot valë,
si liqene plot jetë.

Sytë e saj ishin të mëdhenj sa ëndërrat,
po drita e tyre shkëlqente në një barakë derrash.

Një mëngjes Anxhelika Majer gdhiu e ngrirë.

Sytë e saj të mëdhenj, të mëdhenj diç pyesnin.

Era ulërinte jashtë si egërsirë.

Nënës në sy lotët i kishin ngrirë,

kur mbi të ra një borë e zezë gërmash shtypi:

«Nënë e pakujdesshme, pa zemër në kraharor».

Ajo ngriu e tëra nën atë borë, si shtatore.

Anxhelika Majer kishte dy sy të mëdhenj, të
mëdhenj.

Ata sy tani shohin vetëm errësirë.

Era ulërin jashtë si egërsirë.

Anxhelika Majer me buzët e heshtura thërret.

Anxhelika Majer vështron botën me sytë e shuar.

Anxhelika Majer pret ditën kur mbi trupin e saj të
pajetë,
në vend të luleve, plumbat kanë për të fluturuar.

*
* * *

Duke parë valën që rend të puthë bregun e etur,
pa u kujdesur për dhimbjen që do t'i japë ky
përqaftim,
ndjeva më fort mallin që tani më ka tretur
për ty që më je njëherësh gëzim dhe shqetësim.

PO VIJ TEK TI

Po vij tek ti me hovin përtëritës,
që e përshkon tokën çdo pranverë të re.
Në gisht më lidh veç unazën e dritës,
që do të derdhet gjithnjë mbi ne rrëke.
Mos më pyet për ato që më nuk janë.
Mos më kërko fjalë si brilante e premtime.
Të sjell të ardhmen pa fund e pa anë
dhe dua të ndajmë tok gaze e shqetësime.

N J Ë V A J Z Ë

Bota jote prej kohe është një pasqyrë
e rumbullakët,
ku sheh flokët e gjatë, faqet si zambakët.
Fundi i gjatë ta shtrëngon atë shtat
belkëputur.
Në asfalt, në trotuare vërtitesh si flutur.

Thith si karamele shprehjen «Sa e bukur!»
Mbi libra dhe fletore ka rënë si borë
pluhur.
Ty çdo rrudhëz të tremb pors i kërcënim,
ndërsa shoqeve ballin ua hijeshon
mendimi.

Është e vogël, e ftohtë pasqyra e rumbullakët.
Bota jonë e madhe, shih, si përflaket.

Q Ë N D R E S Ë

Ajo ecte.

Drurët kurorëblertë
seç tundnin kokat
sikur e shoqëronin.

Po ajo tani ndiente një barrë të rëndë:
Nuk ishin bukët në dorë që i rëndonin,
nga gjoksi sikur i kish ikur zemra,
kish veç një zog që dridhej në përpëlitje.
Gjoksi i gufonte...

Fryma po i merrej,
po pas ca hapash
shokët qenë në pritje.

Dhe veç kur duar shokësh asaj iu zgjatën,
dhe veç kur bukët një nga një u ndanë
buzët e saj mundën ta shqiptojnë mandatën:

«Burrin

ballistët ma vranë».

Dhe dhjetra duar

shtrenguan të sajën.

Dhe dhjetra sy e panë të pikëlluar.

Ajo ndjeu sikur dhimbja e saj

në qindra copa

tani qe thërrmuar.

«Motër,

ne do të bënim si të bënim,

të mos kishe ardhur

këtë herë».

Ajo ngriti kokën:

«Lufta ka edhe vdekje,

po gjithkush e lakmon

vdekjen me nder».

*
* *

Ylli i kuq dhe flokët e saj ndrinin në natën e errët.
Ai rrinte zgjuar. Profili i tij ishte i rreptë.

Ajo nënqeshte në gjumë si një fëmijë e mitur.
Pranë tyre shokët flinin të kapitur.
Ylli i kuq dhe flokët e saj ndrinin në natën e errët.
Ai vetullvrenjtur sikur ndiqte një ëndërr.
Në ëndërr e ndiente pranë, më pranë se tokën,
përmendej... Shihte pushkën, natën e errët, shokët.
Shihte tej errësirës një pyll me helmëta...
Me duart e forta vdekjen mbërthente jeta.
Prej saj nuk e ndante veçse një hap. Ajo flinte.
Flinte në gji të s'ardhmes dhe liria që do të vinte.

MËSUESJA

Ajo hyri, e freskët si ajri i mëngjesit.
Një tufë luleshqerra zbardhonte mbi tryezë.
Me sy i pyeti nxënësit kush vallë i kishte lënë,
pastaj u shpërndau të gjithëve buzëqeshjen si një
nënë.

KUJTIM FËMIJËRIE

S'i kisha mbushur shtatë vjeç:
sa i doja ato mëngjese
kur haptë fletët lulja e diellit
dhe ato ngjanin si rreze.

Në oborr vërshonim, si nga mali
vërshon një ortek dëbore;
ajri ngjante si prej kristali,
e thyenin zërat gazmore.

Dhe kish në lodrat tona të thjeshta
aq shumë poezi,
me vrap e ndiqte macja miun
a shfaqej arapi i zi.

Mbi rrugicën në oborr
dielli rrëshqiste i ndritshëm
dhe thurja unë të parat vargje
me ritëm të çuditshëm.

E PËRJETSHMJA

Ti, vogëlush, më the:
«Do shpik një ilaç që njerëzit të mos vdesin».
Ti ende s'e di
që jeta është lumë që gjithçka perpin.
Ka vetëm diçka të përjetshme:
Puna dhe krijimi
dhe ideali që në rrugë na ndrin...

DASHURI

Dashuria për ty
nuk shkrepiti
si rrufe prej qielli.
Pa u ndier
hyre në jetën time
e m'u bëre i nevojshëm
si ajri e si dielli.

Dhe e kuptova se s'mund të jetoje pa mua,
dhe e kuptova se si ti s'do gjeja të dytë.
Pa qenë nevoja që buza të thoshte: «Të dua»
gjithçka kishin thënë sytë.

* * *

Molla e vjetër në oborr si nuse u vesh në të bardha.
Çunaku pa tym në qiell,
flakë krismash
dhe tha:
«Më erdhi radha».

Çunaku mori pushkën, vuri yll në bustinë.
«Do iki, — tha, — nënë e do kthehem me lirinë».
Nëna pa djalin në sy: e kuptoi. Ra në mendim.
I vuri bukë në trastë, i dha zemrën në një vështrim.

Rrugët ishin tërë plagë, të përgjakura e të çara.
Molla e vjetër në oborr si nuse u vesh në të bardha.

TABLO MËNGJESI

Dora e bardhë e agimit ledhaton qiellin.
Toka pi e etur qumështin e rrezeve.
Toka dhe zemra
rilindin mëngjeseve.

Çelin mijëra sytë e qelqtë të dritareve.
Hapat e njerëzve trokasin trotuareve.
Në faqet e të vegjëlve kanë çelur lule molle.
Fëmijët nuk rendin, fluturojnë për në shkollë.

Bashkë me mijëra e mijëra të tjerë ne rendim
bukuritë e palindura me mendje e duar të endim.
Ajrin e freskët, të freskët thithim me
forcë e ëndje.
Është e përjetshme dhe e bukur kjo rendje.

BURIM I PASHTERSHËM

Si trëndafil i flaktë maji në mes të vjeshtës
shpërthen ëndrra e madhe që të gjithëve
na jep jetë,
dhe njerëzit vënë buzët te burimi i freskët,
i gjallë, i pashtershëm

Kongresi i tetë!

Të gjitha kongreset e tua, Partia ime, u ngjajnë
burimeve në shpate mali
me ujë të ftohtë e të kthjellët ku
pimë pa u nginjur,
dhe ne vëmë buzët te ato burime e na
derdhet ndër deje ideali,
andaj shpirti kurrë s'na është thinjur.
Të gjitha kongreset e tua, Partia ime,
shpërthyen nga shkëmbi i madh popullor
dhe derdhën ujvarë dritën ndër mote,

ndaj rruga jote kalon vetëm ndër shtigje
fitoresh
dhe ngrihen tallazet kreshtëborë përreth e
s'të ndalin dot.

Ne kemi ecur me ty dhe kurrë s'kemi rënë,
ne kemi ecur me ty dhe me duar ia shkulëm
qiellit diejt e rrufetë,
se populli të ka ty bijë dhe nënë
dhe thith gjithnjë nga gjiri yt i pashtershëm
forcën dhe jetën.

MAJAKOVSKIT

Ti e ndjeje gjoksin
kafaz për zemrën,
rregullat e ngurta
kafaz për mendimin e lirë,
ashtu si Rusia e carit
qe për ty burg i rëndë.
Çfarë do vallë shqiponja?
Hapësirë,
hapësirë.
Ndërsa kanarina
në kafaz
është e kënaqur.
Pak thërrime
e një këngë,
gjithnjë po ajo.
Oh, ajo të kënaq,
është e këndshme,
e dashur,

vetëm t'i japësh gjithnjë
veç atë që do.
T'ia japësh.

.....

Se ajo s'ia rrëmben dot jetës.
Se për atë është greminë e frikshme
qielli i paanë.
Se për atë është torturë
ngjitja së përpjetës.
Krahët i ka të vegjël,
në fluturim
dot s'e mbajnë.
Dhe ty, poet,
s't'u dhimbs lira e shtrenjtë
asnjë grimë
që t'ia falje të tërën revolucionit.

Të qe e mundur
do ta shndërroje
në konstelacion me yje,
që edhe brezat e ardhshëm
të mrekulluar
atë të shikonin.
Dhe ç'është poezia vallë
pranë punës
ndërtimtare?
Kush mban një botë mbi supe
s'ka kohë për cicërima.

BUZËQESHJA E SHOKËVE

*Shokëve të mi
të sektorit të historisë
së letërsisë.*

E ndrojtur po hyja në tempullin e shkencës,
e mitur,
plot ëndrra,
njëzetvjeçare.

Ju më rrethuat dhe s'më latë vetëm.

Mbi botën e madhe
m'u hap një dritare.

Bulonin plot zjarr e dritë buzëqeshjet
nga zemra juaj e gjerë
si lulet në livadhe.

Unë u ngroha në flakën e tyre

dhe ndjeva

të më përshkonte e shokëve

dashuria e madhe.

FEJESË «MODERNE»

Akullorja në gotë shkrin
bashkë me buzëqeshjen.
Sot si kurrë ndonjëherë,
aq bukur je veshur.
Dora nga unazat ndrin e vetëtin.
Qyteti nga dritat
vezullon si rubin.
Loja e dritave shkrepin
mbi dorën tënde.
Mbi këtë dorë mbështetet
një dorë e huaj e rëndë.
Tej xhameve dritat porsi xhevahirë...
Ti i deshe... po tani ngjan se po të përpijnë.
Një dorë mbi dorën tënde
që s'do jetë më e lirë.
Akullorja e buzëqeshja krejt
tani kanë shkrirë.

N J Ë N Ë N Ë

Fytyra jote
me dritë thjeshtësie
është e mbështjellë.
Buzët e tua qeshin rrallë.
Më shpesh qeshin sytë e thellë.
Në ata sy si burime të kthjellta
shoh të gjallë bijtë që u vranë,
që rrudha në faqe të lanë.
Shkuan mbi fytyrën tënde vitet,
po ajo mbetet e bukur me vijat e rrudhave
rreth syve të thellë,
që të burojnë
dritë.

MONOLOGU I NJË GRUAJE TË RE

Sot ajo nuk më thirri në mëngjes,
ndezi zjarrin,
e dëgjova,
murmuriste ngadalë,
pastaj unë hyra
dhe ajo
nuk foli asnjë fjalë.
I hodha sytë,
nuk më foli,
sytë e saj ishin
të hidhëruar,
sytë e saj
bojë hiri,
që janë
sytë e atij që dua.
Më duket se s'kam parë
asnjëherë
aq rrudha

në kënd të syve të saj,
më duket se s'kam parë
asnjëherë
buzën
t'i dridhet ashtu
si për vaj.
Kur isha fëmijë
ndonjëherë
e fyeja nënën
pastaj rendja tek ajo,
brengën
me puthje t'ia shuaja...
Po, dhe ajo është nënë,
nënë,
nëna e atij që dua.
Pastaj erdhi çupa nga çerdhja,
m'u hodh në qafë,
më rroku,
dhe dora m'u drodh
kur i lëmovava
me dorën time
flokët.

Flokët e saj u ngjajnë
atyre flokëve
që tani po thinjen.
Si t'ia largoj asaj
kujtimin
e fjalëve të hidhura?
Ajo nuk flet,
hesht,
pra,
duhet të flas unë.
Dhe do të flas,
sado e rëndë
të jetë për mua,
se ajo është nënë,
si nëna ime,
është nëna e atij që dua.

MUND TË VDESËSH I BUKUR

Vasil Laçit

Mund të vdesësh i bukur
veç kur bukur ke jetuar.
Pas ca çastesh priste vdekja.
More krehërin në duar.

Prapë t'u shfaqën trëndafilat
që u shndërruan në flakë e zjarr.
Ecje sikur perandori
dhe jo ti — shkonte në varr.

Pas ca hapash priste vdekja—
vdekja dhe pavdekësia.
Kur njeriu vdes në përpjekje
nuk i shuhet bukuria.

VARGJE NË BIBLIOTEKËN E VLORËS

Nëpër xhame është thërrmuar ylberi...
Ngjyrë blu,
e gjelbër,
portokalle,
pastaj e bardhë,
pastaj bojë alle.

Nëpër xhame është thërrmuar ylberi...
ka diçka nga dielli i zjarrtë i Vlorës,
ka diçka nga kaltërsia e qiellit
dhe nga lulet,
livadhet e njoma.

Nëpër xhame është thërrmuar ylberi...
Na buzëqesh kur ngjitemi ndër shkallë,
kur ndër libra ne zhytemi thellë,
na hedh rreze drite nga jeta e gjallë.

PËR VDEKJEN E DIKTATORIT FRANKO

Ai ishte prej kohe i vdekur, i vdekur
dhe hijen e vdekjes ia hodhi një vendi të tërë,
Spanjën, që mbajti në prehërin e saj të gjerë
burrat dhe gratë që patën brejtur hekur.
Dhe hija e zezë u ra ullinjve me kokrrat e kaltra
dhe detit, trëndafilave dhe dritës diellore.
Futën e zezë vuri në kryet e bukur Spanja,
Dhe nënave iu tha qumështi ndër krahërore.
Ai ishte prej kohe i vdekur, i vdekur.
Dhe mbolli farën e vdekjes në tokën që i dha jetë
dhe lirinë e ndrydhi me gjak e me hekur
dhe mbi gjak e mbi hekur ngriti fronin e vet.

Tani vdiq. Trualli amtar s'do të pranojë ta tretë
trupin e atij që mbyti në agim revolucionin
dhe që me dorë të vet zjarret e inkuizionit
ringjalli dhe një herë në shekullin e njëzetë.
Në vend të tij do vijë një fantazmë mbreti,
një kukull që vërtitet në dorë të barkmëdhenjve.
Buçet me këngë të lashtë e ngre tallaze deti
ashtu si heronjtë e rinj kokën krenare ngrënë.

1975

* * *

... dhe mbrëmja si piktore derdhte ngjyra.
Sytë etshëm pinin... Dhe s'thoshnim dot: «Sa bukur!»
Heshtnim. E ngjante se një rreze e padukur
herë pas here na ndizte fytyrat.

FJALË NËNE

Bijë, jeta të ka në gji prej ca ditësh,
unë jo prej nëntë muajsh,
po prej aq vjetësh.
Ti ke qenë imja
para se të të prekte drita,
më parë se zemra jote
të rrihte në timen.
Bijë, pa kuptuar ti më vështron e buzëqesh.
Buzëqeshje e lot do të të falë jeta,
dhe unë do të të jap
gjithçka ajo më dha.

NJERIU — SHKRESE

Mbi tryezë të tij librat si roje rrinë.
Pluhuri i mbulon. Po njerëzit nuk e dinë.

Ai fillon e flet. Prej buzës i rrjedh
po prej kohe i ka harruar ai udhët mjaltë,
Prej kohe i ka harruar udhët e me baltë.
Pas tymit të cigares i mjegullohet
Në tryezë të tij ngrihen mal përpjeta.
Prej kohe e ka harruar skeda e letra.
udhën që çon te zemra.

SHPËRTHIM ËNDRRE

*Një inxhinierereje në uzinën e koksit
në metalurgjik*

Përparësja jote e bardhë mban erë

mëngjesi.

Faqet e tua janë petale trëndafilash rozë.

Të mos qenë ata sy me thellësinë

e zezë

do të ngjaje fëmijë që niset për në shkollë.

Dhe sytë e tu digjen po ashtu

si koksi

që ëndërron të nxjerrësh nga qymyri ynë.

Dhe kjo ëndërr është për ty njësoj

si për gjoksin

kur me tërë muskujt merr lirisht frymë.

Kjo ëndërr më se rrezet e diellit të

ka dehur

dhe pret ta shohësh të gjallë ashtu

si presin fëmijët.

Tani e vjetra rrëshqet si gjarpër
i fshehur,
dhe në vend të armëve përleshen
mendimet.
Sa kjo hapësirë e blertë të zgjerohet zemra:
koksi do dalë nga qymyri shqiptar.

MBRËMJEN E PARË QË ERDHI DRITA
NË MALËSI

Një çast i tillë provohet
vetëm një herë në jetë.
Ai ngre kokën e thinjur ngadalë.
Nuk i ka njohur kurrë lotët,
veç dridhmën e trupit nga uria.
Kokën mbi radio mbështet.
Shpërthen në lot si fëmija.
Dikur besonte në mrekulli.
Kjo mrekulli është e vërtetë.
Dhoma mbytur në dritë.
Fytyrat njomur në buzëqeshje.

1970

POETI ËSHTË SI DETI

Poeti është si deti,
dhe plak dhe i ri.
Poezia është jetë
dhe jeta është poezi.

Kur kënga të jep fletë,
kur je poet vërtet,
të rënda s'janë tetëdhjetë,
të lehta s'janë njëzet.

Poeti rron në këngë
dhe kënga rron përjetë.
Të pleqërisë brengë
zjarri i poezisë e tret.

Poezia është shpatë drite,
dhe kush në dorë e mban
si kreshnik i pret vitet
edhe përpara çan!

PËR LABORANTËT E AZOTIKUT

Këtu s'ka gjë që të mos ndrisë:
kokrrat e bardha dhe epruvetat.
Më erdhi ndër mend befaz mesjeta
dhe bota e errët e alkemisë
kur ëndrrën e lashtë të njerëzisë
atë eliksirin jetëdhënës
disa ia lypnin veç magjisë,
larg zhurmës, dritës dhe larg njerëzve.
Tani shndrijnë epruvetat
dhe i shtrëngojnë dhjetra duar.
Çudi e shekullit t'njëzetë,
çudi e njerëzve të bashkuar.
Në këto shishe, këto epruveta
ku shndrit nitrati i amonit
është pjelloria, është jeta,
është buka e valë që mban aromë.
Këtu s'ka gjë që të mos ndrisë;
përparset borë dhe fytyrat.
Dhe unë e di: Ju të rinisë
e kini gjetur eliksirin.

ATA ISHIN PESË

*Pesë revolucionarëve të pushkatuar
në Spanjë.*

Ata ishin pesë.

Qielli i Spanjës kishte një kaltërsi verbuese.

Barishte plot vesë.

Ata ishin pesë.

Ecnin përmes bajonetave

si rrezet përmes një pylli.

Ata ishin pesë,

si pesë cepat e yllit.

Ata ishin pesë,

si gishtërinjtë e një dore

që prodhon bukën, hekurin,

që e bën tokën pjellore.

Ata ishin pesë.

Kur plumbat i patën shtrirë
si pesë gishtërinjtë e një
dore prekën zemrën e
Spanjës
që të rrahë një ditë e
lirë.

1975

STALINI

Si toka lisat
populli lind prijsat.
Kur dallgë revolucionit
të vjetrën përpinin
koha të lindi
pranë Leninit.
Në beteja t'ashpra,
gjithë krah për krah
mësues e kishe
dhe shok dhe vëlla.
Ai ndezi dritën,
ti zjarr i dhe.
Tok me të ngrite
një botë të re.
Dhe të vdekur armiqtë
druheshin nga ti,
prandaj kërkuan
të t'bënin hi.

Posi feniksi
rilind nga hiri
revolucionit
iu ktheve te gjiri...

JEHONA E ZËRIT TËND

*Kujtimet të shoqeve të masakruara
nga pushtuesit nazi-fashistë*

Thikat e dhimbjes
të çanin trupin pa reshtur,
po ti qëndrove
e fortë,
e heshtur.

Dhe digjte rinia
në krahërorin e zhuritur,
dëshira për jetë,
për ajër,
qiell të ndritur.

Kryqet e thyer zgërdhiheshin përpara teje,
dhe ti qëndrove
si në betejë.

Kur të çuan përballë tytave,
ti mbaje kokën lart
dhe buzëqeshje akoma,
dhe nuk shihje vdekjen.

Dielli përballë të ngjiste si ëndrra e artë e
vëllezërve.
Ti deshe të merrje në dorë
atë top prej flake
dhe t'ua përplasje
në fytyrë xhelatëve.
S'deshe të t'i lidhnin
sytë që shihnin qartë.
Ti re,
dhe u përhap në çdo kënd
jehona e zërit tënd.

KËNGË GËZIMI PËR FËMIJËN E PARË

Më ngjan në çastet që tek ti po kthehem
sikur më përshkon krejt një gaz i fshehtë.

Në krahë tani ndiej një peshë të ëmbël,
që më rëndon e më bën aq të lehtë.

Shih: s'është mrekulli, po një gjë aq e thjeshtë.

Kjo qenie e vogël, që është në krahët e mia
dhe që merr frymë aq lehtë, aq lehtë,
je ti, jam unë: është vetë dashuria.

Vetë dashuria, që bashkë na ka shkrirë
dhe që me bebëza t'ndritshme fëmije tash sheh
jetën.

Krahët e vegjël ngjajnë si t'bardha fletë,
që do fluturojnë drejt një kohe edhe më t'mirë.

U RIZGJUA PËLLUMBI

Vëllezërve arbëreshë.

Vijnë ata, po vijnë
këtu në tokën mëmë.

Zgjaten, zgjaten degët
të kërkojnë rrënjët.

Pluhurin e shekujve
hedhin prapa tyre.

Dashuri e Arbrit
ndrin në sytë pasqyrë.

Fluturuan shekujt,
të rëndë nga zjarri e plumbi.

Rrahu krahët drejt Arbrit
përsëri pëllumbi.

P E R M B A J T J A

Tok me fshatarët	3
Partisë	4
Letër nga metalurgjiku	5
Baladë irlandeze 	7
Thjeshtësi	9
Zëri yt	11
Përshëndetje	12
Zemra bëhet shqipe	13
Kënga e tipografëve	14
Zëri i fushës	15
Poezisë	16
Këngë partizane	18
Ardhja e pranverës	19
Çast në kufi	20
Për ata që nuk vdesin	21
Mendimet e një mësueseje të re	22
Shoqes së kursit	24
Më duket	26
Bredhi i Vitit të Ri	27
Celiku lind përmes zjarrit	29
Ne, vullnetarët	31
Vargje në Krujë	32
Dhuratë Jolit për 1 Majin	33
Shoqes së dikurshme të aksionit	35
Kur t'i harroj lulet	36
Fjalët e para	37
Kthimi	39
Çaste aksioni	40
Buzë liqenit të Pogradecit	42

Axhelika Majer	43
Duke parë valën	45
Po vij tek ti	46
Një vajzë	47
Qëndresë	48
Ylli i kuq	50
Mësuesja	51
Kujtim fëmijërie	52
E përjetshmja	54
Dashuri	55
Molla e vjetër në oborr	56
Tablo mëngjesi	57
Burim i pashtershëm	58
Majakovskit	60
Buzëqeshja e shokëve	63
Fejesë «moderne»	64
Një nëne	65
Monologu i një gruaje të re	66
Mund të vdesësh i bukur	69
Vargje në bibliotekën e Vlorës	70
Për vdekjen e diktatorit Franko	71
Mbrëmja si piktoresë	73
Fjalë nëne	74
Njeriu — shkresë	75
Shpërthim ëndrre	76
Mbrëmjen e parë që erdhi drita në malësi	78
Poeti është si deti	79
Për laborantët e azotikut	81
Ata ishin pesë	82
Stalini	84
Jehona e zërit tënd	86
Këngë gëzimi për fëmijën e parë	88
U rizgjua pëllumbi	89